

KËRKESË
Nr. 291/7, datë 13.10.2021

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Agjencia Shtetërore për Shpronësimin shpall kërkesën për shpronësim për interes publik të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga projekti “Rikualifikimi urban i lulishtes panoramike pranë lumit Devoll, blloku nr. 1, qyteti Maliq”.

Subjekti kërkuar i këtij projekti është Bashkia Maliq.

Me anë të këtij publikimi kërkojmë të vëmë në dijeni personat e prekur nga ky shpronësim për pasuritë e paluajtshme, pronë private, të cilët do të kompensohen sipas vlerësimit paraprak të llogaritur, bazuar në VKM-në nr. 89, datë 3.2.2016, “Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë”, për pasuritë e llojit “truall”, si dhe bazuar në vendimin nr. 138, datë 23.2.2000, “Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përlogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive, pronë private, që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik”, për pasuritë e llojit “ndërtesë banimi ose jobanimi”, sipas tabelës paraprake bashkëlidhur.

Vlera totale paraprake e shpronësimit është 858,333 (tetëqind e pesëdhjetë e tetë mijë e treqind e tridhjetë e tre) lekë.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM
KRYETAR I KOMISIONIT
TË POSAÇËM TË SHPRONËSIMEVE
Erlis Hereni

**LISTA EMËRORE PARAPRAKE E PRONARËVE QË PREKEN NGA ZBATIMI I PROJEKTIT
“RIKUALIFIKIMI URBAN I LULISHTES PANORAMIKE PRANË LUMIT DEVOLL, BLLOKU NR. 1, QYTETI MALIQ”**

Nr.	PRONARI			TË DHËNAT (mbi pasurinë, sipas ASHK Korçë)									VLERËSIMET PËR SHPRONËSIM, SIPAS LLOJIT TË PASURISË						SHËNIME	
	Emri	Atësia	Mbiemri	Fshati ose qyteti	Zona kadastrale	Nr. i pasurisë	Lloji i pasurisë	Sip. totale (m²)	Truall (m²)	Ndërtesë (m²)	Volumi	Faqe	Ndërtesë			Truall				VLERA TOTALE (lekë)
													Sipërfaqja (m²)	Çmimi (lek/m²)	Vlera (lekë)	Sipërfaqja (m²)	Çmimi (lek/m²)	Vlera (lekë)		
1	Andrea Jani Bazelli, Pranvera Avni Ibo, Anesti Jani Bazelli, Andon Jani Bazelli			Maliq	2573	1/120	Truall + ndërtesë	53	53	50.4	8	120	50.4	Situacion/ çmimet e EKB-së	764,258	53	1,775	94,075	858,333	Konfirmuar nga ASHK-ja “pasuria nr. 1/120, në radhorët e hipotekës, figuron e regjistruar kontrata e shitblerjes me nr. 4353 rep., nr. 3153 kol., datë 28.10.1996, sipas së cilës Avni Bazelli ka blerë objektin “Agjencia Maliq”, së bashku me truallin me sip. 50.4 m²”.
2	Shtet			Maliq	2573	1/433	Truall	1791.6	1791.6	0	9	231	0		0	0	0	0	0	Konfirmuar nga ASHK-ja.
Vlera totale e shpronësimit në lekë																			858,333	